

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi , me sekretaren juridike Kadrije Zymberi në lëndën penale kundër të pandehurit B. S. nga Gj. për shkak të veprës penale,sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së e sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2171/16 të dates:14.12.2016, më datën 21.12.2016, mori këtë :**

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :

**B. S., i lindur më datën:..., në Gj. vendbanim në rr. "...", nr. ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.**

**Është fajtore  
Sepse**

*Më datën ... , rreth orës ... minuta në Gj. në rrugën" ..." në lokalit SH.P.K, "...", i pandehuri me dashje e ka përdorur forcën ndaj personit tjetër të dëmtuarit Sh. A., në atë mënyr që pas një mosmarrëveshje verbale lidhur me ndërhyrjet ne i-emailit e të pandehurit në lidhje me disa rezervime për sigurime shëndetësore i pandehuri me kokë e godet të dëmtuarin në fytyr ku ndërhyr V. R. dhe i ndan*

**- me këtë ka kryer veprën penale ,Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së.**

*Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,22,31 41, 42,43,46, dhe 73, të KPRK, si dhe nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton*

**DËNIM ME GJOBË**

**Ashtu që të pandehurit B. S. i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë) euro të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 1 (një) muaii, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.**

*Nëse i pandehuri refuzon që ta paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë,do ti shëndërrohet në dënim me burgim ku një ditë burgimi do te i llogaritet nga 20 euro.*

*Obligohet që i pandehuri t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga 10 €, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.*

*Prokuroria Themelore në Gjiilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit B. S. nga Gj., i lindur me datën ... në Gj. me vendbanim në rr” ...”, nr. ... k. Gj..*

*Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjiilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjën e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit te pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënimi me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.*

*Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjën e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit B. S. dhe i shqiptoi dënimi me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.*

*Në bazë të deklaratës së të pandehurit, gjyqtari konstatoi se i pandehuri B. S., me dashje e ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

*Gjyqtari ka konstatuar se me veprimin e të pandehurit B. S. nga Gjilani, të gjitha elementet e veprës penale, sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilin është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan.*

*Duke u bazuar në këto që u ceken më lart, gjykata e ka pranuar kërkesën e PTH dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënimi me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPK.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP,*

*Nga të cekurat më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Më 20.12.2016**

**Sekretarja juridike,**  
**Kadrije Zymberi**

**Gjyqtari,**  
**Ramiz Azizi**

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njejtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.